



Food and Agriculture
Organization of the
United Nations



Krijimi dhe kujdesimi për kulturat pyjore



Projekti: Mbështetje në zbatimin e
politikave dhe strategjive pyjore
në Kosovë

GCP/KOS/005/FIN



Pyjet e mbjella përbëhen prej drurëve të rritur nga mbjellja dhe/ose përmes hedhjes së paramenduar të farërave të llojeve autoktone ose llojeve të futura.

Ku mund të krijohen grumbujt pyjorë në mënyrë artificiale?

- » Nuk ka rregull të përgjithshme për shkak të shumëllojshmërisë së kushteve dhe shumëllojshmërisë së llojeve të përshtatshme të drurëve.
- » Secili vend duhet të ekzaminohet individualisht!
- » Zakonisht, menaxherët e pyjeve punojnë me dhe, gjë që nuk është produktive (p.sh. jo e përshtatshme për bujqësi intensive), prandaj burimet janë të kufizuara.
- » Gjithmonë para mbjelljes kontrolloni profilin e dheut të vendit

Pyllëzimi apo ripyllëzimi?

Pyllëzimi: Kthimi i tokave për shfrytëzime të tjera në shfrytëzim si tokë pyjore. Për shembull: mbjellja e tokës së dikurshme bujqësore, djerrinës, kullosës, mbetjeve minerare

Ripyllëzimi: Pyjet kanë qenë të pranishme në vend, por shfrytëzimi i tokës ka ndryshuar për një periudhë, ose pyjet nuk mund të gjenerojnë më pa mbështetje aktive. Për shembull: pastrimi i zonave me prerje, vendet pyjore të degraduara ose zabelet, dhe toka ku ndryshimi i llojeve është i dëshirueshëm

Referencat për Kosovë do të kuptohen në kontekst të rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së (1999).



Plani i mbjelljes

Gjithmonë përgatitni një plan, madje edhe për hapësira të vogla

Planet duhet gjithmonë të përfshijnë:

- Përshkrimi i tokës, topografinë dhe kushtet klimatike
- Vendi se ku të mbillet
- Çfarë llojesh të mbillen
- Përbërja e grumbujve të ardhshëm/për-puthja e llojeve me vendin
- Puna përgatitore
- Teknika për mbjellje
- Koha për mbjellje
- Informata se ku të ruhen fidanët

©Pixabay

Plani i mbjelljes

Përzgjedhja e llojeve të drurëve varet nga qëllimi i mbjelljes. Për shembull, në djerrina mund të mbillen llojet e drurëve të rinj. Pyjet e degraduara duhet të përmirësohen me lloje të drurëve, të cilët ofrojnë grumbuj pyjorë me cilësi më të mirë. Grumbujt pyjorë të mbjellë mund të jenë monokultura ose grumbuj të përzier.

Përgatitja e vendit mund të jetë e plotë ose e pjesërishtme, manuale ose e mekanizuar. Kjo punë përfshin përgatitjen e vendit për mbjellje; veçanërisht çlirimi i dheut, largimi i rrënjëve të mëdha dhe i vegjetacionit konkurrues si dhe i vegjetacionit që mund të jetë pengesë për mbjellje.

Faktorët që shpijnë në mbjellje të suksesshme

- Përputhja e vendit me llojin
- Fidanët e cilësisë së lartë të llojit të duhur
- Përputhja e kushteve të vendit me kushtet e fidanishtes, nëse është e mundur, në mënyrë që të shmanget ose të zvogëlohet në minimum "tronditja" nga zhvendosja e fidanëve, preferohet që fidanët të merren nga fidanishtja që ka kushte të ngjashme sikurse vendi i mbjelljes.
- Trajtimi i fidanëve në fidanishte dhe gjatë transportimit deri në vendin e mbjelljes
- Teknika(t) e mbjelljes
- Kushtet klimatike gjatë mbjelljes dhe në javët në vijim

Trajtimi i fidanëve para mbjelljes

- Fidanët duhet të mbrohen nga dielli dhe era
- Transportimi i fidanëve duhet të jetë sa më i shkurtër që është e mundur (për të gjitha llojet e fidanëve)
- Duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë rrënjëve të vogla që mund të jenë shumë të ndjeshme ndaj thatësisë

Një fidan ka cilësi të mirë atëherë kur:

- Pjesa e sipërme është e zhvilluar mirë
- Është vertikalisht i drejtë
- Rrënjët duhen të forta
- Niveli i hollësisë është i ulët
- Duken vital dhe kanë ngjyrë të duhur

Llojet e fidanëve





Fidanët me rrënjë të zhveshur (ose të hapur)



Fidanët në kontejnerë

Trajtimi i fidanëve para mbjelljes

Kur të dërgohen në vendin e mbjelljes



Fidanët me rrënjë të zhveshur duhet të groposen menjëherë (preferohet në shtrat me dhe)


Fidanët në kontejnerë duhet të vendosen afër ujit, në mënyrë që të ujiten kur është nevojshme

Mbjellja në gropë


Kjo është teknika më e zakonshme për fidanët me rrënjë të zhveshur dhe mund të bëhet në mënyrë manuale ose të mekanizuar. Dimensionet më të shpeshta të gropës janë 40x40x40 cm, 30x30x30cm, ose më pak, mirëpo ajo duhet t'i mundësojë rrënjës hapësirë të mjaftueshme.

Kur e hapni gropën:



- Hiqni shtresën e gjelbër, barërat e këqija dhe shtresën e sipërme organike.
- Vini mënjanë shtresën e sipërme të dheut, e cila do të përdoret më vonë për të mbuluar rrënjët.




- Në anën tjetër, lini mënjane dheun e shtresës së poshtme, e cila do të përdoret për të mbuluar pjesën tjetër të gropës.
- Hiqni gurët dhe rrënjët e mëdha.
- Gjatë mbjelljes, vendoseni fidanin në gropë me një dorë, dhe me dorën tjetër mbulojeni gropën me dheun e parë. Në të njëjtën kohë, tërhiqni fidanët pak lart.




- Fidanët e llojeve të drurëve që nuk kanë sistem rrënjor boshtor, mirëpo kanë sistem të cekët (p.sh. bredhi) duhet të mbillen në grumbullin e dheut të gropës.
- Vendoseni pjesën mbitokësore të fidanit në mënyrë vertikale.
- Fidanët duhet të shtrëngohen në tokë duke e shtypur dheun përreth rrënjëve.



- Shtypeni pjesën tjetër të dheut me këmbë, mirëpo kuni kujdes meqë rrënjët nuk duhet të thyhen. Mos lini vrime të ajrit rreth sistemit rrënjor.
- Kur të përfundojë mbjellja, fidani duhet të tërhiqet lehtë nga lart. Nëse fidani nuk lëviz nga vrime, atëherë mbjellja është bërë si duhet. Nëse fidani mund të lëvizet nga vrime, mbjellja duhet të përsëritet. Kjo procedurë është edhe mënyra e duhur për kontrollimin e mbjelljes.




Mbjellja e suksesshme e fidanëve:



Mjetet e punës:

Lopata, shati, kazma, gërshërët (për prerjen e rrënjëve)

- Për këtë teknikë të mbjelljes përdoret më së shpeshti një shat i vogël ose i posaçëm. Fidani mbillet nën tehun e shatit.
- Mënyra më e mirë është në tokë të butë, pa shumë barëra të këqija.



- Prerja në tokë mund të bëhet në mënyrë vertikale ose në një kënd prej 45°. Prerja këndore është më e lehtë, mirëpo mangësia kryesore e saj është pozita jo e rregullt e sistemit rrënjor, e cila mund të shkaktojë deformimin e saj.



Mjetet e punës:

Shufra për mbjellje, lopatat me formë të veçantë, shati ose shkopi.



©FAO/Hübert Inhaizer

Mbjellja e fidanëve në kontejnerë

- Këto mund të mbillen gjatë gjithë periudhës së vegjetacionit, nga pranvera në dimër, me përjashtim kur ngrihet toka ose kur ajo zonë ka pasur sezon të gjatë thatësie.
- Fidanët duhet të kenë cilësi të mirë; duhet të kenë ushqim dhe ujë të mjaftueshëm që nga fillimi
- Mbjellja zakonisht është më ekonomike dhe më efikase.
- Mund t'i përdorim teknikat e njëjta sikurse për fidanët me rrënjë të zhveshur. Gropa duhet të jetë një e treta e gjysmë më e madhe se sa sistemi rrënjor (madhësia e kontejnerit).



Kur duhet të mbjellim?

Mbjellja bëhet në vjeshtë dhe në pranverë. Mbjellja në vjeshtë mund të bëhet nga fillimi tetorit e derisa toka të fillojë të ngrihet dhe kjo është më e përshtatshme për llojet gjetherënëse.

Periodha e mbjelljes në pranverë fillon atëherë kur fillojnë të shkrihen bora dhe toka e ngrirë dhe duhet të përfundojë deri në kohën kur të çelin sythat. Kjo periudhë është e përshtatshme për të gjitha llojet e drurëve, mirëpo rekomandohet veçanërisht për llojet e drurëve halorë.

Për mbjellje të suksesshme janë të rëndësishme edhe kushtet atmosferike – për rezultate të mira në mbjellje nevojitet një mot me re dhe i lagësht, por pa erë.




Densiteti i mbjelljes

Densiteti i mbjelljes varen nga llojet e drurëve, kushtet e terrenit dhe qëllimet e mbjelljes. Densiteti mbjelljes duhet të mundësojnë që kurorat e fidanëve të bashkohen sa më shpejt. Në tokat e varfra dhe të thata përdoret densiteti më i ulët. Zonat më të ndriçuara kanë nevojë për densitet më të lartë


LLOJET E DRURIT	DENSITETI (COPEË/HA)
Dushku	7.000-10.000
Ahu	5.000-10.000
Bredhi	2.000-4.000
Pisha	3.000-10.000

Gjeometria e mbjelljes


Gjeometria më efikase e mbjelljes është në formë katrore.



Dushku-ahu
(1,5m x 0,75m)



Pisha
(2,0m x 0,6-0,5m)



Bredhi
(2,5m x 2,5m)

Organizimi i punës

- Mbetjet duhet të vendosen në grumbull ose vargje për të lehtësuar qasjen
- Vendet për ruajtjen e bimëve dhe distribuimi duhet të planifikohen paraprakisht dhe të shtrihen në zonën e mbjelljes në mënyrë sa më të barabartë, për të zvogëluar distancat e transportimit
- Punëtorët duhet të trajnohen për të mbajtur pozitën optimale të trupit, si në shfrytëzimin e peshës trupore për ngulitjen e mjeteve për mbjellje, për të shmangur përdredhjen e shpinës dhe përdorimi i mjeteve për mbjellje si mbështetje gjatë kërrusjes.
- Punëtorët duhet t'i bëjnë punët me radhë, si mbjelljen dhe bartjen e bimëve, për të siguruar shumëllojshmëri dhe për të shmangur mbjelljen e përsëritur me cikël të shkurtër.

- Gjatë mbjelljes në terren të pjerrët, drejtimi i mbjelljes duhet gjithmonë të jetë përpjetë, për të shmangur kërrusjen e tepërt të shpinës.

Pajisjet

- Gjatë bartjes së kontejnerëve ose fidanëve në grumbuj, duhet të përdoren çanta shpine të përshtatshme me shpërndarje të mirë të peshës
- Transportimi manual i fidanëve në distanca të gjata duhet të shmanget.
- Mjetet e përdorura për mbjellje duhet të jenë të disejnuara për atë qëllim (p.sh. shufra për mbjellje)
- Dorëzat e mjeteve për mbjellje duhet të jenë të dizajnuara për të zvogëluar në minimum bartjen e dridhjeve në dorë, në rast se shpata godet ndonjë shkëmb të fshehur ose ndonjë rrënjë.
- Tehet e mjeteve për mbjellje duhet të jenë të sigurta dhe të dorëzat të mos kenë ashkla dhe çarje.
- Tehet e mjeteve për mbjellje duhet të mbahen të mprehta.
- Në vendin e punës duhet të mbani lima të përshtatshme për mprehjen e teheve.

Gjatë mbjelljes

Gjatë dhe pas mbjelljes, duhet të kontrollohen këto në vijim:


- Siguria profesionale
- Gjendja e pajisjeve
- Mjetet duhet të jenë në dispozicion për punëtorë

- Trajtimi i fidanëve, (veçanërisht transportimi dhe ruajtja)
- Kontrollimi i gjeometrisë së mbjelljes
- Kontrolloni fidanët e mbjella pas çdo punëtori, për t'u siguruar që ata e kanë përdorur teknikën e duhur

Vitet e para pas mbjelljes

Mbjellja plotësuese është e nevojshme nëse fidanët janë në gjendje të keqe, janë tharë. Në e përdorim këtë masë atëherë kur një zonë më e madhe ose një pjesë e madhe e mbjelljes fillestare ka qenë e pasuksesshme (më shumë se 15-20% e fidanëve të mbjella në fillim).

Duhet të përfshijnë rigjenerimin natyror në formim ose një grumbull të ri në një zonë të mbjellë. Kjo ka rëndësi shumë të madhe në monokulturat e gjetherënësve.



Përkujdesja për pyjet e reja

Pas rregullimit, do të thotë densitetit të duhur dhe shpërndarjes hapësinore të

fidanëve, përkujdesja ka rëndësi të veçantë në vitet e mëvonshme të mbjelljes, sepse mbjellja është vetëm fillimi i jetëgjatësisë së një pylli të ri.

Hapi i ardhshëm është të sigurohet mbi-jetesa e fidanëve të mbjella dhe zhvillimi i tyre.

Masa e parë e kësaj faze është krijimi i një mikroklima të favorshme në nivel tokësor me anë të rregullimit të barërave të këqija.

Vini re: Nëse barërat e këqija janë shumë të shkurtra, niveli i tokës do të jetë më pak i lagësht, mirëpo nëse janë shumë të larta, nuk do të ketë diell për bimë!

Kontrollimi i barërave të këqija

Prerja e barërave të këqija në lartësinë e duhur kontribuon në suksesin e mbjelljes.

Lagështia është një faktor i rëndësishëm veçanërisht në zonat e thata, nëse barërat e këqija priten shumë shkurtë, ka mundësi që fidanët të digjen.

Drita e diellit:



Fidanët që durojnë hijen



Fidanët që nuk e tolerojnë hijen



Illustrations: Marijan Močivnik

